

Lista e Institucioneve Publike, 2022

Tiranë, 12 Shtator 2023: INSTAT, ofron për përdoruesin listën e institucioneve publike, pjesë e sektorit të Qeverisë së Përgjithshme, si dhe ndërmarrjet Financiare dhe Jo-financiare, në pronësi të entiteteve publike për vitin 2022.

[Lista e institucioneve publike, pjesë e sektorit publik](#) (link)

Njësitë shpenzuese buxhetore të Sektorit Publik përbëhen nga: nën-sektori i Qeverisë Qendrore (S.1311) me 850 njësi shpenzuese buxhetore, nën-sektori i Qeverisë Lokale (S.1313) me 206 njësi shpenzuese buxhetore dhe nën-sektori Fondet e Sigurimeve (S.1314) me 2 njësi shpenzuese.

Ndryshimi i numrit të njësive shpenzuese buxhetore ndër vite vjen si rrjedhojë e ndryshimeve strukturore të Qeverisë, riklasifikimeve, si dhe njësive të reja apo të mbyllura.

Tab. 1 Sektori Publik në Shqipëri, Viti 2022

Klasifikimi sipas nën-sektorëve		Viti 2022
Qeveria Qendrore	S.1311	909
<i>Buxhetore¹</i>		850
<i>Extra-Buxhetore</i>		59
Qeveria Federale ²	S.1312	-
Qeveria Lokale	S.1313	328
<i>Buxhetore</i>		206
<i>Extra-Buxhetore</i>		122
Fondet e Sigurimeve	S.1314	2
Ndërmarrjet Publike Jo-financiare	S.11001	28
Ndërmarrjet Publike Financiare	S.12	2
Banka Qendrore	S.121	1
Totali i Njësive Shpenzuese		1.270

Njësitë extra-buxhetore të Sektorit Publik përbëhen nga nën-sektori i Qeverisë Qendrore (S.1311) me 59 njësi shpenzuese dhe nën-sektori i Qeverisë Lokale (S.1313) me 122 njësi shpenzuese.

Përveç institucioneve buxhetore dhe extra-buxhetore, sektori publik, përfshin edhe nën-sektorin e ndërmarrjeve Publike Jo-financiare (S.11001) me 28 njësi, nën-sektorin e ndërmarrjeve Publike Financiare (S.12) me 2 njësi dhe nën-sektorin e Bankës Qendrore (S.121) me 1 njësi.

¹ Numri i Njësive Shpenzuese buxhetore përbëhet nga njësitë aktive shpenzuese që raportohen në sistemin e thesarit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë për vitin 2022.

² S.1312 - Qeveria Federale, ky nën-sektor nuk aplikohet në Shqipëri.